



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

Nr. 2522 Prot.

Dt. 29.08.2025.

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet

UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS

dhe

INSTITUTIT PËR SHKENCËN DHE TEKNOLOGJINË "INSI" SH.P.K



Instituti i Shkencës Dhe i Teknologjisë Insi
SH.P.K

Nr. 10 Dt. 14/08/2025
Prishtinë

Bazë ligjore :

Ky Memorandum i Bashkëpunimit hartohet në mbështje të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; Statutin e UBT-së, miratuar me urdhrin nr. 586, datë 02.12.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Palët nënshkruese:

Universiteti Bujqësor i Tiranës, (në vijim "UBT"), institucion publik i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, një nga institucionet më të rëndësishme të formimit universitar dhe pasuniversitar, të kërkimit shkencor, trajnimit dhe ekstensionit në fushat e bujqësisë, mjedisit, veterinarisë, pyjeve dhe bioteknologjisë, **i përfaqësuar nga Rektori Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU**, me ID G61120169K, i emëruar me Dekretin nr. 316, datë 26.08.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e autoritetit më të lartë akademik dhe përfaqësuesit ligjor të UBT-së për çështjet akademike dhe protokollare, me seli në "Kodër-Kamzë", Tiranë.

dhe

Instituti për Shkencë dhe Teknologji "INSI" SH.P.K, me numër të biznesit 810801945, me seli: Bregu i Diellit, Qendra e Re Tregtare, nr.42, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, e përfaqësuar nga drejtori Z. Ismajl Baftijari, në vijim e cilësuar si "INSI".

U pajtuan që të bashkëpunojnë në ngritjen profesionale të studentëve të UBT (duke i angazhuar për hulumtime në projektet e INSI-të, duke ofruar mundësi për punë praktike, dhe duke ofruar kushte dhe mundësi për studentë të zgjedhur për përgatitje të temave të diplomës dhe Master-it), me theks te fushat e departamentit të Mjedisit, Bujqësisë, Agronomisë, Arkitekturës së Peizazhit, por edhe fushat tjera të interesit të përbashkët. Palët u pajtuan se INSI mund edhe të rekrutojë stafin e ardhshëm nga studentët praktikantë të UBT për të punuar brenda INSI-të.

Palët pajtohen të shfrytëzojnë kapacitetet e përbashkëta profesionale të UBT dhe INSI-të në projekte me interes të përbashkët duke përfshirë këtu edhe projektet nga Erasmus+, për studime dhe analiza dhe për aplikim në thirrje publike për projekte së bashku.

Palët bien dakord si më poshtë:

I. Qëllimi i Memorandumit të Bashkëpunimit

- a. Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është të promovojë ngritjen profesionale të studentëve të Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT) dhe të forcojë bashkëpunimin ndërmjet UBT-së dhe Institutit për Shkencë dhe Teknologji (INSI), në kuadër të pjesëmarrjes, konkurrimit dhe zbatimit të projekteve të ndryshme, të fituara individualisht ose në bashkëpunim, në fusha me interes të përbashkët për të dyja palët, përfshirë projektet e mbështetura nga programi Erasmus+.
- b. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, INSI angazhohet të pranojë një numër të caktuar studentësh të UBT-së për zhvillimin e praktikës profesionale, në përputhje me nevojat dhe kapacitetet e saj për angazhimin e studentëve.

II. Detyrat dhe përgjegjësitë e INSI-t

Për realizimin e këtij memorandumi, INSI SH.P.K merr përsipër të përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

- Të caktojë një mentor për secilin student të UBT-së, i cili do të udhëheqë dhe mbikëqyrë ecurinë e praktikës profesionale;
- Të sigurojë kushtet e nevojshme për zhvillimin e praktikës, duke garantuar praninë e studentëve në ambientet e INSI-t gjatë gjithë periudhës së praktikës profesionale;
- Të lejojë qasjen e studentëve në informacionet përkatëse të INSI-t, në përputhje me politikat e brendshme të konfidencialitetit dhe sigurisë së kompanisë;
- Të informojë studentët mbi rregullat e brendshme të punës, përfshirë orarin, hyrje-daljet, detyrimet mbi konfidencialitetin, si dhe çdo rregull tjetër që ka të bëjë me disiplinën dhe etikën në punë;
- Të përgatisë dhe organizojë programet e praktikës profesionale dhe, kur kërkohet nga UBT, të hartojë raportin përfundimtar mbi ecurinë e praktikës për secilin student;
- Të informojë UBT-në për çdo problematikë që mund të paraqitet gjatë zhvillimit të praktikës, si dhe për çdo informacion tjetër të rëndësishëm në lidhje me studentët në praktikë;
- Të sigurojë që asnjë student të mos pranohet për praktikë pa një fletë-udhëzim (kontratë e praktikës profesionale) të nënshkruar nga koordinatori i praktikës dhe të vulosur nga UBT;

- Të angazhojë studentët e UBT-së në aktivitete profesionale dhe kërkime në përputhje me fushat përkatëse të studimit, me fokus të veçantë në mjedis, bujqësi, agronomi, arkitekturë peizazhi, si dhe në aktivitete të tjera në terren apo në zyrë;
- Të informojë UBT-në për projektet me interes të përbashkët dhe të kërkojë emrat e personave potencialë nga UBT për përfshirje në aplikime të përbashkëta.

III. Detyrat dhe përgjegjësitë e UBT

Për realizimin e këtij memorandum, Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) merr përsipër të përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

- Të përpilojë listën e studentëve që do të kryejnë praktikën profesionale pranë INSI-t, në përputhje me kriteret dhe nevojat e përcaktuara;
- Të informojë studentët e përzgjedhur për praktikë mbi detyrimin për të respektuar politikat, procedurat dhe rregullat e brendshme të INSI-t;
- Të informojë INSI-n lidhur me të dhënat individuale të secilit student të përzgjedhur, me qëllim përgatitjen e kontratës së praktikës profesionale;
- Të zëvendësojë studentin në praktikë, brenda një afati maksimal prej shtatë ditësh pune nga momenti i njoftimit zyrtar të INSI-t, në rast se studenti nuk përmbush rregullat dhe përgjegjësitë e praktikës profesionale;
- Të pajisë çdo student me një certifikatë përfundimtare për praktikën profesionale, e lëshuar në bashkëpunim me INSI-n dhe e nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar të të dy institucioneve;
- Të propozojë studentë për angazhim në punë dhe kërkime praktike, veçanërisht në fusha të tilla si mjedisi, bujqësia, agronomia, arkitektura e peizazhit (në terren dhe në zyrë), si dhe në fusha të tjera përkatëse;
- Të bashkëpunojë me INSI-n në identifikimin dhe përgatitjen e projekteve me interes të përbashkët, si dhe të propozojë përfaqësues nga UBT që mund të angazhohen si bashkëaplikues apo drejtues në aplikimet për projektet e përbashkëta.

IV. Fillimi dhe kohëzgjatja e praktikës profesionale

- a. Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet në momentin e nënshkrimit nga të dyja palët, UBT dhe INSI.
- b. Data e fillimit të praktikës profesionale për secilin grup studentësh do të përcaktohet nga INSI, në varësi të mundësive organizative dhe kushteve të krijuara për pranimin e tyre.

- c. Kohëzgjatja standarde e praktikës profesionale do të jetë një (1) muaj. Nëse ekziston interes i ndërsjellë, praktikantit/praktikantes mund t'i ofrohet mundësia për zgjatjen e periudhës së praktikës, me marrëveshje të veçantë ndërmjet INSI-t dhe studentit, me dijeni dhe miratim të UBT-së.

V. Dispozitat Përfundimtare

a. **Pajtueshmëria e palëve**

Palët nënshkruese, Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) dhe Instituti për Shkencë dhe Teknologji (INSI), deklarojnë se janë plotësisht dakord me të gjitha dispozitat e këtij Memorandumi të Bashkëpunimit dhe angazhohen për zbatimin e tij të plotë.

b. **Përgjegjësitë ligjore**

Secila palë zotohet të përmbushë detyrimet dhe përgjegjësitë e saj sipas përcaktimeve të këtij Memorandumi, në përputhje me kuadrin ligjor përkatës të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës.

c. **Zbatimi dhe koordinimi**

Palët bien dakord të mbajnë komunikim të vazhdueshëm për të siguruar një zbatim efikas të këtij Memorandumi, si dhe të bashkëpunojnë në mënyrë të strukturuar për shkëmbimin e përvojave, informacionit dhe veprimtarive me interes të përbashkët.

d. **Ndryshimi i memorandumit**

Çdo ndryshim, shtesë apo interpretim i dispozitave të këtij Memorandumi realizohet vetëm me mirëkuptim të ndërsjellë dhe përmes një marrëveshjeje të veçantë me shkrim, të nënshkruar nga përfaqësuesit ligjorë të të dyja palëve.

e. **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të këtij Memorandumi, të cilat nuk zgjidhen me marrëveshje të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve, do t'i nënshtrohen zgjidhjes përmes negociatave institucionale, ose nëse palët bien dakord, përmes një mekanizmi të ndërmjetësimit të përbashkët.

f. **Përfundimi i memorandumit**

Ky Memorandum mund të përfundojë me njoftim të njëanshëm me shkrim nga secila palë, duke respektuar një afat minimal prej një (1) muaji nga data e marrjes së njoftimit nga pala tjetër.

VI. Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave

Palët angazhohen të ruajnë konfidencialitetin e çdo informacioni të ndjeshëm ose të klasifikuar që u bëhet i ditur gjatë zbatimit të këtij Memorandumi. Trajtimi i të dhënave personale do të kryhet në përputhje me legjislacionin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë dhe të Kosovës.

VII. Hyrja në fuqi

- a. Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij nga përfaqësuesit ligjorë të autorizuar të Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT) dhe Institutit për Shkencë dhe Teknologji (INSI).
- b. Ky memorandum përgatitet në dy (2) kopje origjinale, nga të cilat secila palë nënshkruese mban një (1) kopje.

Për:

**UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË
TIRANËS**

Rektori i UBT :

Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU

Tiranë më, 27/07/2025

Për:

**Institutin për Shkencë dhe Teknologji
“INSI” SH.P.K**

Drejtör :

Z. Ismajl BAFTIJARI

Tiranë, më 19/08/2025